



## **Paratë dhe tatimet**

Llogaria bankare / qarkullimi i pagesave

Tatimet

Borxhet

Të jetosh me pak para

## **Llogaria bankare / qarkullimi i pagesave**

Kush fiton para dhe duhet të paguajë fatura, ka nevojë për një llogari bankare ose në bankë ose në postë. Për blerjet, kartelat debitore apo kreditore janë shumë të përhapura.

### **Llogaria bankare**

Në Zvicër pothuajse secila banore dhe secili banorë ka një llogari bankare. Të punësuarve normalisht iu transferohet rroga vetëm në llogarinë bankare. Shumë banka dhe posta ofrojnë llogari bankare për persona private. Hapja e një llogarie bankare normalisht është falas. Mirëpo pastaj shkaktohen taksa të ndryshme. Ngase taksat, interesat dhe shërbimet ndryshojnë sipas ofruesit, ia vlen të bëhet krahasimi. Për hapjen e një llogarie bankare nevojitet në çdo rast pasaporta apo letërnjoftimi.

### **Kartelat debitore / kartelat kreditore**

Kush zotëron një llogari bankare, merr normalisht një kartelë kreditore për të tërhequr para kesh. Kjo kartelë është e vlefshme vetëm në bankën e vet. Mirëpo bankat apo posta ofrojnë edhe kartela debitore (p.sh. Maestro), me të cilat mund të tërheqësh para në të gjithë bankomatat dhe të paguash në shumicën e dyqaneve. Këto kartela mund të përdoren edhe jashtë vendit. Në varësi të kartelës shkaktohen taksa të ndryshme. Kartelat kreditore mund të porositën te ofrues të ndryshëm. Shërbimet dhe taksat janë shumë të ndryshme, krahasimi ia vlen. Pagesa me kartelë debitore apo kreditore ndërkohë është shumë e përhapur.

## **Pagesa e faturave**

Faturat (Rechnungen) dërgohen normalisht përmes postës me një fletëpagesë ose me e-mail. Ka tri mundësi për t'i paguar:

- E- Banking: Pagesa përmes internetit është shumë e përhapur dhe e sigurt.
- Në sportel: Me fletëpagesën mund të paguash me para të gatshme në postë. Kush ka një llogari bankare te posta, mund të porosisë transferimin e pagesës direkt prej llogarisë bankare. Klientet dhe klientët e bankës mund të porosisin pagesat edhe në sportelin e bankës.
- Përmes postës: Urdhrat e pagesave mund të dërgohen edhe me letër në bankë apo në postë. Informacione më të detajuara ju ofrojnë banka apo posta.

Mundësitë për pagesën e faturave të përsëritshme:

- Skema e debitimit direkt (LSV) është e rehatshme, ngaqë pagesa e faturave kryhet automatikisht nga llogaria bankare. Informacione për këtë japin dërguesit e faturave apo banka/posta.
- Nëse shuma e faturës është gjithnjë e njëjtë (p.sh. qiraja), mund të bëhet një urdhëresë automatike për pagesën (Dauerauftrag) në bankë apo postë.

Faturat janë gjithmonë me një afat të caktuar për pagesë. Nëse afati nuk respektohet, si pasojë mund të ketë: Një mbledhje e borxhit nga zyra e përmbaruesit (Betreibung).

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/konto--qarkullimi-i-pagesave](http://www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/konto--qarkullimi-i-pagesave)

## Tatimet

Ngarkesa me tatimet në Zvicër varet nga vendbanimi. Tatimet më të rëndësishme për personat privatë janë tatimi mbi të ardhurat, tatimet mbi pasurinë dhe tatimi në vlerën e shtuar.

### Sistemi tatimor

Në Zvicër konfederata, kantonet, komunat dhe bashkësitë fetare sipas të drejtës publike marrin tatime (Steuern). Ka tatime direkte dhe indirekte. Tatimet më të rëndësishme direkte janë tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi pasurinë, këto duhet të paguhen direkt nga personi, që e ka detyrimin tatimor. Tatimet indirekte ndër të tjera janë tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi për duhan apo tatimi për naftë. Këto tatime përfshihen në çmimin e mallrave. Meqë kantonet dhe komunat kanë përgjegjësinë për shumë tatime, ekzistojnë dallime të mëdha në tatimet direkte mes vendbanimeve. Bashkëshortët tatimohen së bashku.

### Tatimi në burim

Personave të shpërngulur tani prej jashtë vendit iu zbritet tatimi mbi të ardhurat direkt nga rroga (tatim në burim, Quellensteuer). Lajmërimin e bën punëdhënësi për punëmarrësit.

- Lartësia e tatimit varet nga të ardhurat, prej gjendjes familjare (i pamartuar, i martuar, i divorcuar) dhe numrit të fëmijëve. Ndryshimet duhet të lajmërohen menjëherë.
- Prej tatimit në burim zbritje të ndryshme shtesë janë të mundur, p.sh. për depozitime në shtyllën nr. 3, interesa për borxhe, shpenzime të larta për sëmundje etj..
- Kush ka pasuri, duhet ta deklarojë atë dhe të paguajë tatime veçmas për këtë.
- Për të ardhura vjetore prej 120`000 frangave e më shumë duhet të dorëzohet një formular për deklarimin e tatimeve (tatim vjetor i rregullt).
- Kush është martuar me një bashkëshorte apo një bashkëshort me një pasaportë zvicerane apo leje për vendqëndrim pa kufizim C, duhet po ashtu të plotësojë një deklaram të tatimeve (tatim vjetor i rregullt).

Administrata tatimore e kantonit (Kantonale Steuerverwaltung) jep informacione të mëtejshme për tatimin në burim. Administrata tatimore e kantonit ndihmon në pyetje për tatimin mbi pasurinë.

## **Tatim vjetor i rregullt**

Personat me pasaportë zvicerane apo me leje për vendqëndrim pa kufizim C ngarkohen me tatim vjetor të rregullt (ordentliche Besteuerung). Atyre nuk iu zbritet tatimi prej rrogës. Ata duhet të plotësojnë një formular për deklarimin e tatimeve dhe t'i paguajnë tatimet me faturë. Formulari për deklarimin e tatimeve mund të plotësohet edhe onlajn. Rekomandohet të bëhet një pagesë paraprake (Vorauszahlung). Lartësia e tatimeve të pritura mund të përlogaritet me llogaritësin e tatimeve (Steuerrechner). Plotësimi i formularit për deklarimin e tatimeve është edhe për zviceranet dhe zviceranët diçka komplekse. Është e këshillueshme, që të kërkosh ndihmë gjatë plotësimit, kur e bën për herë të parë.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/tatimet](http://www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/tatimet)

## Borxhet

Kur dikush nuk i paguan faturat në kohën e duhur, kjo mund të ketë pasoja serioze. Në probleme me financat, qendrat këshilluese për borxhe ofrojnë mbështetje.

### **Paralajmërimet dhe mbledhja e borxhit nga zyra përmbarese**

Ai që nuk paguan një faturë me kohë, merr normalisht një paralajmërim të parë dhe të dytë (Mahnung). Sado, kreditorët edhe kanë mundësinë në çdo kohë të nisin mbledhjen e borxhit (Betreibung) nga zyra e përmbaresit. Në këtë rast debitorja apo debitori merr një urdhër për pagesë nga zyra përgjegjëse e përmbaresit (Betreibungsamt). Me këtë shkaktohen taksa. Kush është i mendimit, që mbledhja e borxhit nuk është e drejtë ndaj tij, mund të mbrohet te zyra kompetente e përmbaresit nga mbledhja e borxhit me një deklaratë kontestuese (Rechtsvorschlag). Kujdes: Përmbarimi mund të çojë në sekuestrimin e rrogës apo të gjërave me vlerë. Përveç kësaj përmbarimet regjistrohen në regjistrin e përmbarimeve (Betreibungsregister) (edhe kur debitori në fund ka paguar). Kjo ndër të tjera mund të paraqesë problem gjatë kërimit të një banese.

### **Borxhet**

Kush ka probleme financiare apo borxhe, mund t'i drejtohet një këshillimoreje për borxhe (Schuldenberatungsstelle). Aty ai gjen mbështetje. Ekspertët shikojnë situatën së bashku me të prekurin dhe kërkojnë zgjidhje. Organizata Caritas ofron një këshillim anonim përmes telefonit: "SOS-Schulden" Beratungs-Hotline, Telefon 0800 708 708 (falas). Sipas nevojës i prekuri do të dërgohet në një zyrë tjetër. Këshillimorja Plusminus ofron ndihmë dhe informacione të dobishme.

### **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/borxhet](http://www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/borxhet)

## Të jetosh me pak para

Jeta në Zvicër është relativisht e shtrenjtë. Prandaj mund të jetë e leverdishme, që të blesh artikuj të caktuar, të cilët janë të përdorur. Kush është në nevojë financiare, mund të blejë lirë në dyqane speciale.

### Artikujt e përdorur

Në Zvicër ka shumë dyqane me mallra të përdorur (Brockenhäuser). Aty munden të blihen artikuj të përdorur shumë lirë. Në tregje speciale edhe persona privatë ofrojnë sende të përdorura. Shembuj janë tregjet me gjëra të përdorura (Flohmärkte), tregje teshash, tregje pajisjesh për ski etj. Edhe portalet në internet janë shumë të pëlqyer për blerje dhe shitje të artikujve të përdorur.

### Sporti / Kultura / Arsimimi

Me letërnjoftimin Kulturlegi njerëzit me pak para marrin zbritje për organizime të kohës së lirë, të sportit, kulturës dhe arsimit. Aplikimi për këtë letërnjoftim mund të bëhet në Caritas. Caritasi jep informacione dhe shqyrton, nëse një person ka të drejtë të ketë Kulturlegi. Me Familienpass, FamilienpassPlus ose colorkey merrni gjithashtu zbritje për shumë aktivitete.

### Tregu i Caritasit

Njerëzit me pak para mund të blejnë ushqime dhe produkte për nevoja ditore me çmime shumë të ulëta në dyqanet nga Caritas (Caritas Markt). Për këtë nevojitet një kartë speciale, për të cilën aplikimi bëhet në Caritas. Caritas jep informacione dhe kontrollon, nëse një person ka të drejtë për kartën. Ka një dyqan në Bazel.

### Mbështetja shtetërore

Kush nuk ka mjaft para për të jetuar, ka në shumë raste të drejtën për mbështetje nga shteti. Kështu për shembull mund të aplikohet për zbritje në kontributet e sigurimeve shëndetësore apo për bursat për arsimim. Në situata të caktuara jetësore mund të merren pagesa nga sigurimet sociale apo nga ndihma sociale. Familjet me pak para mund të aplikojnë në kushte të caktuara për kontribute përkrahjeje për qiranë e tyre (Familienmietzinsbeiträge).

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/te-jetosh-me-pak-para](http://www.hallo-baselstadt.ch/sq/parat-dhe-tatimi/te-jetosh-me-pak-para)